REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF INFRASTRUCTURE
Njësia Org. / Org. Jedinica / Org. Unit: KM-MIT
Nr. i Prot. / Broj Prot. / Prot. No.: 251/19
Nr i Faqeve / Br. Stranica / No. Pages: 1
Data / Datum / Date: 19.04.19
PRISHTINË/A

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF INFRASTRUCTURE
Njësia Org. / Org. Jedinica / Org. Unit: 01
Nr. i Prot. / Broj Prot. / Prot. No.: 4192
Nr i Faqeve / Br. Stranica / No. Pages: 01
Data / Datum / Date: 23.04.19

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
***Qeveria –Vlada-Government***
Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit/Ministarstvo Infrastrukture i Transporta
Ministry of Infrastructure and Transport

Ministri i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit , në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2) , të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 17 (paragrafi 5 dhe paragrafi 6) dhe nenin 38 (paragrafi 3) të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011), Rregulloren Nr.26/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenin 131 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 5 dhe 21 të Ligjit nr.04/L-179 për Transportin Rrugor, nenin 7 të Udhëzimit Administrativ 09/2013 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndërurban të udhëtarëve me autobus, nenin 7 të Udhëzimit Administrativ nr. 06/2016 dhe rekomandimit te komisionit profesional, nxjerr këtë:

# VENDIM

**I. Aprovohet** kërkesa nr.2153 e operatorit të transportit rrugor të udhëtarëve me autobus "Arditi Tours"shpk me seli në Ferizaj për marrjen e nisjeve ne relacionin Ferizaj - Gjilan dhe anasjelltas me oraret e nisjeve (12:40 – 14:20; 17:40 – 19:20).

*Arsyetim*

Pas shqyrtimit të aplikacioneve dhe verifikimit të dokumentacionit dhe shkresave të tjera të lëndës dhe duke u bazuar në legjislacionin në fuqi repektivisht Ligjin nr.04/L-179 për Transportin Rrugor dhe Udhëzimin Administrativ nr. 09/2013 mbi rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndër-urban të udhëtarëve me autobus i plotësuar dhe ndryshuar me Udhëzimin Administrativ nr.06/2016, është konstatuar që operatori transportues rrugor të udhëtarëve me autobus "Arditi Tours"shpk me seli në

Ferizaj për marrjen e nisjeve ne relacionin Ferizaj - Gjilan dhe anasjelltas me oraret e nisjeve (12:40 - 14:20; 17:40 - 19:20) ka plotësuar kushtet ligjore për ndarjen e nisjeve të lira në relacionin e lartëcekur të përcaktuara sipas nenit 8 të U.A nr. 09/2013 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit në transportin ner urban të udhëtarëve me autobus si dhe kushtet e shpalljes publike.

Andaj në bazë të kësaj që u tha më lartë, është vendosur si në dispozitiv.

**Këshilla Juridike:**

Kundër këtij Vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtrojë ankesë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Transportit brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga dita e publikimit të vendimit.

**Pal LEKAJ**

Ministër

I dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Kabinetit të Sekretarit të Përgjithshëm;
- Deparatmentit të Transportit Tokësor;
- Operatorit Transportues;
- Arhivit.